



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 08.03.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen -

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1.Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

Marrin pjesë² :

- | | |
|--------------------------|------------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 6. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 7. Medi Bici | (anëtar zëvendësues) |
| 8. Gurali Brahimllari | (anëtar zëvendësues) |
| 9. Klodiana Veizi (Mema) | (anëtare zëvendësuese) |

¹Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

²Anëtarja e Fatjona Memçaj nuk merr pjesë në diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore normative, për shkak të papajtueshmërisë-marrëdhënie krushqie e afërt me kandidaten Ardita Alsula. Sipas ligjit, Kryetari i Këshillit e ka miratuar heqjen dorë me vendimin nr.1 datë 14.02.2019.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016 :

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.
2. Genci Gjoncaj, përfaqësues i Kryetarit të Kuvendit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED :

1. Agnes Bernard, drejtuese e misionit EURALIUS
2. Julinda Beqiraj, ekspert i EURALIUS
3. Maniela Sota, Koço Bendo, përkthyes për EURALIUS

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen me sipas rendit të ditës lidhur me projektaktin : *Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.*

Pas parashtrimit nga Kryetari i Këshillit të riformulimeve në dispozitat e Kreut III Seksioni A “Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit”, mbledhja vijon më diskutimin e dispozitave të Seksionit B “ Shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga Këshilli”.

Në vijim të diskutimeve, *Erinda Ballanca* kërkon fjalën dhe parashtron se për pikën 33 dhe 34 shikojmë përsëri një ndryshim nga sa është vendosur në rregulloren përgjithshme. Duket sikur po i kthehemi edhe njëherë një diskutimi që ka të bëjë me pozicionin e Avokatit të

Popullit dhe subjekteve të tjera në këtë mbledhje. Së pari sipas Rregullores për Funkcionimin e KED dhe nenit 16 të saj, Avokati i Popullit ka një rol të ndryshëm nga subjektet e tjerë, për shkak se ligji e përcaktonte një gjë të tillë dhe ky Këshill ra dakord që të kishte atë interpretim ligjor. Këtu shikoj që Avokati i Popullit ndryshon pozicionin, nuk i njihet afati 7 ditor që edhe ai duhet të ketë të njëjtën mënyrë për tu njohur me çdo lloj materiali që ka të bëjë me mbledhjet e Këshillit, por tani dërgohet vetëm relacioni dhe jo materialet e dosjes. Kështu që në këtë mënyrë rikthehem përsëri tek e njëjta çështje dhe nuk e kuptoj pse është propozuar kështu sepse kjo tashmë është një vendimmarrje që është marrë nga Këshilli, pra që Avokati i Popullit duhet të ketë të njëjtat të drejta procedurale si anëtarët, përveç votës. Prandaj, kërkoj që nisur nga pozicioni i Avokatit të Popullit, të respektohet i njëjti afat njoftimi, si edhe ti dërgohen jo vetëm relacioni, sepse në pikën 34 thuhet vetëm relacion, por edhe materialet së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori. Ndërkohë që për anëtarët dërgohet materiali dhe relacioni. Këto çështje dhe dispozita janë trajtuar dhe ju i keni votuar në këtë mbledhje dhe ti kthehem edhe njëherë për votim, mua nuk më duket shumë e drejtë dhe kërkoj që për këto pika të reflektojmë vendimmarrjet e mëparshme të mbledhjeve të këtij Këshilli. Roli dhe veprimtaria e këtij organi është rankimi i kandidatëve, verifikimi i cilësive të tyre. Çfarë vlere do të kishte roli i veçantë i Avokatit të Popullit siç është në rregullore, nëse nuk do ta kishte më pikërisht këtë funksion. Nëse ju mendoni që e drejta e Avokati i Popullit është vetëm për të bërë rregulloret e përgjithshme apo për të parë rregullore, vetëm aty duhet të ketë materiale informacione etj, ky është një koncept në gjykimin tim shumë i kufizuar dhe realisht më vjen keq që ju vazhdoni dhe i jepni Këshillit përsëri për vendimmarrje një çështje ku ju keni dalë në pakicë. Pra nuk është edhe etike që megjithëse keni dalë në pakicë në momentin që Këshilli mund të ketë pjesëmarrje tjetër, ju e sillni dhe njëherë çështjen për diskutim. Realisht jam shumë e habitur që kjo çështje mund të shtrohet prapë për diskutim. Ky Këshill qëllim të vetëm nuk ka bërjen e rregullave të brendshme, por ka rankimin e kandidatëve dhe nëse në rregulloren e brendshme kemi përcaktuar si do të funksionojmë për të bërë punën tonë që është rankimi i kandidatëve, nuk mundet të ketë një normim tjetër si do ta bëjmë ne punën tonë për këtë. Këtu keni rregulla me specifike për mënyrën çfarë do veprojmë në rastin konkret por kjo nuk do të thotë që rregullat e përgjithshme që janë në rregullore duhet ti ndryshojmë nëpërmjet këtij akti. **Këtë propozim** mund ta kishit sjellë siç është procedura si një kërkesë për amendim të rregullores për të parë edhe ne të tjerët. Nëse Këshilli mendon që duhet të amendojë një rregullore që është miratuar nuk ka problem, por ne ende nuk e kemi parë atë rregullore në zbatim. Nuk kam asnjë problem personalisht, vendimmarrjen sigurisht e keni ju, por nëse

vendosni një standart transparence, më vjen jashtëzakonisht shumë keq që ky standard transparence të ulet menjëherë

Gene Gjonçaj, kërkon fjalën dhe parashtron se, nuk është se ka ndonjë kundërshti ndërmjet asaj çfarë është propozuar në projektaktin tuaj dhe rregullores, pra nuk e shoh një çështje esenciale. Avokati i Popullit ka shumë të drejta në këtë proces, por pa dyshim Avokati i Popullit nuk mund të bëjë dot relatorin, për një çështje të caktuar e për një kandidat të caktuar. Sipas Avokates së Popullit ajo ka të gjitha të drejtat procedurale me përjashtim të drejtës së votës, ndaj pyetja ime mund të ishte nëse mund të bëni ju punën e relatorit në këtë tryezë. Avokati i Popullit në këtë tryezë duhet të kujdeset nëse respektohen procedurat, nëse sigurohet transparenca, nëse veprimet kryhen konform procedurave dhe afateve të përcaktuara,. Për sa i takon pastaj përmbajtjes dhe vendimmarrjes, kjo është çështje e anëtarit të KED dhe e Këshillit si organ i vendimmarrjes.

Bledar Dervishaj, kërkon fjalën dhe parashtron se, Avokati i Popullit ka një shqetësim të drejtë. Avokati i Popullit në rregulloren që është miratuar nga Këshilli përpara dy mbledhjeve, ka fituar një pritshmëri të ligjshme, jo vetëm të ligjshme por edhe kushtetuese, se ai është pjesëmarrës në proces dhe do të ruajë interesin publik duke pasur të drejta shumë më tepër se ne që jemi prezent si të ftuar, që jemi organe emërtese. Nëse këto rregulla ndryshojnë papritur, ashtu siç tha Avokati i Popullit, e kufizojnë mundësinë e tij për të pasur akses të plotë në dokumente. Pse po ndodh kjo gjë në këtë rregullore duhet të arsyetohet gjatë nga anëtarët e Këshillit dhe pastaj Këshilli duhet ta marrë në vlerësim me votim siç mori rregulloren e parë. Kjo lidhet edhe me disa nene të tjera që do vijnë më pas, ku ka ndryshim standardi nga rregullorja e organizimit të funksionimit sa i takon mbledhjes për vendimmarrje dhe mbledhjes në dhoma këshillimi. Unë ftoj që Këshilli ti shtrojë për debat këto dy nene që kundërshtuam, pikat që ne shtruum sepse kjo do shkojë në logjikë e në vijë të drejtë me të gjithë nenet që vijnë më pas. Do të mbështesja variantin për transparencën të plotë ndaj Avokatit të Popullit, ashtu siç Këshilli vendosi. Nëse Këshilli vendos ndryshe, duhet të vendosë pas një shterimi të një diskutimi në tryezë e të mos kalojë në këtë mënyrë pa u vënë re.

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesja), kërkon fjalën dhe parashtron se, do të doja që të ndaja pozicionin e EURALIUS mbi këtë çështje. Duke bërë një hap pas, doja të kujtoja pak rolin e ligjvënësve dhe rolin e hartuesve të Kushtetutës. Një ndër objektivat kryesore të ndryshimeve që kanë ndodhur dhe të reformës në drejtësi ka qenë depolitizimi dhe kufizimi i ndikimit të qeverisjes apo të ekzekutivit në marrjen e vendimeve për personat në sistemin gjyqësor në Shqipëri. Në fakt, ky ishte diskutim goxha i gjatë dhe institucioni i KED ka qenë një prej rekomandimeve të marra nga Komisioni i Venecias në këtë aspekt, me qëllimin kryesor

që, kur flitet për vendimmarrjen, për pozicionin e tij, të mund të shmangej sa më shumë të ishte e mundur pjesëmarrja në vendimmarrje e politikës dhe influencave të ndryshme politike. Kjo me qëllimin kryesor që të kishim një organ teknik, puro teknik, i cili do të merrte më pas vendimet në këtë lëndë. Ndërkohë që, për pozicione të tjera, ka organe të tjera të cilat e luajnë këtë rol, psh. për pjesën e prokurorisë e kemi tek KLP. Dhe në rastin në fjalë nuk është se ishte parashikuar më përpara një institucion i posaçëm që do merrej me kandidaturat e Gjykatës Kushtetuese apo të ILD dhe qëllimi kryesor i këtij organi siç e dini është që të realizoni sa më shumë depolitizimin dhe që të sigurohet një përbërje teknike e tij tërësisht të ndarë nga pjesa e ekzekutivit. Ky organ të mund të propozojë për vendimmarrjen persona që kanë kaluar sitën tuaj dhe vlerësimin tuaj.

Kushtetuta e ka parashikuar qartë rolin e Avokatit të Popullit si rol vëzhgues në këtë proces. Dhe ndërkohë ka specifikuar ligji më pas edhe rolin të ftuarve e të partive politike që mund të qëndrojnë në rolin e të ftuarve në takime të tilla. Ndërkohë, sa i takon rolit të të ftuarve, duke marrë parasysh objektivin kryesor të depolitizimit, mendojmë që të ftuarit duhet të qëndrojnë sa më larg kësaj sallë të jetë e mundur dhe të shprehen e të flasin vetëm atëherë kur u kërkohet që të shprehen. Ndërsa Avokati i Popullit ka rolin vëzhguesit. Vëzhguesi nuk është anëtar dhe nuk është anëtar me të drejtë vote. Roli vëzhguesit është që të vëzhgojë atë çfarë ndodh edhe siç e dimë, vëzhguesi nuk merr pjesë në procesin e vendimmarrjes për sa i takon verifikimit dhe renditjes. Ligji në vetvete parashikon një tjetër rol që është roli i gjykatave. Gjykata ka akses në të gjitha dosjet dhe gjykata ka të drejtën që të marrë vendim qoftë edhe mbi mendimin e KED-së, mbështetur në të gjitha provat që është pjesë e dosjes që ato marrin. Por vëzhguesi ka rolin e vëzhguesit dhe shikon, vëzhgon se si realizohen rregullat dhe si përmbushen detyrat. Me sa kuptojmë Kushtetutën dhe ligjin nuk mendojmë që Avokati i Popullit duhet të ketë akses në dosje apo në shqyrtimet ose diskutimet të Këshillit.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtron se zonja Agnes, ju nuk keni qenë këtu kur ky Këshill ka interpretuar dispozitën kushtetuese dhe ka bërë vendimmarrjen përkatëse, duke e trajtuar të ndarë lidhjen e vëzhguesit në procedurën e hedhjes së shortit me atë të pjesëmarrjes në mbledhjet dhe veprimtarinë e KED. Pra neni 149 i Kushtetutës në pikën 3 e trajton Avokatin e Popullit si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit, pra merr pjesë si vëzhgues në këtë procedurë, si edhe merr pjesë në mbledhjen dhe veprimtarinë e KED-së. Më tej Ligji, vetë neni 233, nuk përcakton më fare fjalën vëzhgues por që Avokati i Popullit merr pjesë në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit. Pra nëse ligji, të vetmen dritë transparence për mbledhjet e mbyllura, përcakton këtë pjesëmarrje, nuk e kuptoj se si mund të rindryshohet apo të ridimensionohet përsëri pozicioni i Avokatit të Popullit për sa kohë që vendimi i këtij Këshilli

është marrë. Pra pozicioni i Avokatit të Popullit se cili do të jetë, çfarë aksesit do të ketë, deri ku do të jetë, është i përcaktuar në këtë ligj. Sa i përket shqetësimit të kryetarit në lidhje me faktin që mbledhjet janë të mbyllura, ato vërtet janë të mbyllura por menjëherë pas asaj fjalie tregon se kush merr pjesë jo vetëm në mbledhje por dhe në veprimtari. A është pjesë e veprimtarisë tuaj vendimmarrja? Nëse nuk është pjesë e veprimtarisë tuaj vendimmarrja, atëherë unë tërhiqem, nëse vendimmarrja siç thotë ligji është pjesë e veprimtarisë unë besoj që këtu nuk mund të ketë diskutim. Ndoshta znj. Agnes mund ta kenë pasur ju dhe EURALIUS mund ta kenë patur ndryshe mendimin kur kenë bërë ligjin, por si e kenë shkruar është kështu siç po e lexojmë dhe nuk është hera e parë që ka qenë një tjetër mendim në mendje të shkruajtësve dhe është pasqyruar ndryshe në legjislacion. Ju nuk kenë qenë në atë mbledhje për hir të së vërtetës, por Këshilli e ka diskutuar shumë gjërë e gjatë këtë çështje dhe ka arritur në këtë diskutim dhe në këtë qëndrim.

Këshilli ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër.

PJESA E DYTË E MBLEDHJES

Anëtarët e Këshillit dhe pjesëmarrësit e tjerë, pas pushimit, vijojnë diskutimet mbi përmbajtjen e dispozitave të Kreut III Seksioni B “Shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga Këshilli”.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtron se jam në një nga nga pozicionet më të vështira që mund të konsiderohen pasi më duhet që të paraqes një argument i cili në një farë mënyre duket sikur unë dua të marr më shumë kompetenca në këtë Këshill sesa ato që të paktën përcakton ligji. Në fakt e vërteta ka të bëjë me ato që janë parimet thelbësore dhe kryesore të procedurave administrative të cilat janë të ndryshme nga procedurat gjyqësore. Veprimtaria e këtij Këshilli është e përcaktuar qartë që duhet ti përmbushë funksionet e tij duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor me qëllim për të siguruar cilësi sa më të lartë profesionale dhe morale në përbërjen e organeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni. Unë nuk shikoj se si pjesëmarrja e Avokatit të Popullit për sa kohë është e përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligj e minon këtë proces. Eventualisht duket sikur Avokati i Popullit që është institucion kushtetues i pavarur i cili mbron standardet më të larta të drejtave të njeriut, është një institucion ose përfaqësohet nga një individ i cili mundet të minojë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese. Roli i Avokatit të Popullit me reformën në drejtësi është rritur në mënyrë thelbësore dhe ka pasur një shtim të mandateve të tij në Kushtetutë dhe në ligje pikërisht sepse është identifikuar si një organ që e ka bërë punën e tij në përputhje me

parashikimet ligjore dhe unë besoj se roli që ne kemi pasur deri më tash me reformën në drejtësi është lavdëruar nga çdokush. Nuk është gjetur asnjë veprim jo në përputhje me ligjin apo në tejkalim të kompetencave të institucionit të Avokatit të Popullit. Ekzistenca dhe vlera e vëzhguesve çojnë në zhvillimin e një procesi transparent ku njerëzit janë të përgjegjshëm për vendimet që marrin dhe u qëndrojnë atyre vendimeve sepse janë të argumentuara. Në të gjitha rastet unë nuk kam asgjë për të fshehur nga asnjëri prej nesh në qoftë se mbajmë një standard dhe një qëndrim. Nëse e them në prani vetëm të anëtarëve në dhomë këshillimi apo në prani të më shumë njerëzve mendimin tim nëse është i argumentuar i bazuar në ligj dhe i drejtë. Në këtë kontekst edhe procedura e organeve të rivlerësimit, që është KPK-ja, vëzhgohet nga dikush, megjithëse ato janë procedura administrative dhe në rastin konkret vëzhgohet nga OMN-ja, të cilët, ndonëse quhen vëzhgues kanë një sërë kompetencash të përcaktuara qartë në ligj të cilat ata i ushtrojnë në mënyrën e tyre. Nuk i hyj kompetencave që ata ushtrojnë po ata quhen vëzhgues. Nuk kam as edhe një dyshim që ata i ushtrojnë kompetencat e tyre në përputhje me ligjin. Aty për shkak të çështjes ka qënë shumë specifike, kryejnë çdo veprim që mund të kryejnë dhe marrin pjesë edhe në dhomën e mbyllur të këshillimit të vendimmarrjes. Ndërkohë që në rastin konkret legjislatori nuk ka qënë kaq i hollësishëm por ka përcaktuar në nenin e transparencës fjalët Avokati i Popullit merr pjesë në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit. E vlerësoj përsëri se neni 233 nuk e përcakton si vëzhgues, por thotë merr pjesë. Nëse akti do të kalojë në formën në të cilën është paraqitur për diskutim do të thotë që ka pjesë të mbledhjeve në të cilën unë nuk marr pjesë dhe sigurisht akti nuk është në linjë me nenin 233. Por a mundemi me një akt normativ të deleguar të ndryshojmë ligjin? A do mundem të kërkoj zbatimin e ligjit drejtpërdrejt dhe të vij në çdo mbledhje pavarësisht se ju s'do më. Unë do vij gjithsesi se e përcakton ligji që do të marr pjesë në mbledhje dhe nuk ma kufizoni dot. Janë procedurat e tjera të brendshme a kam të drejtë të flas apo s'kam të drejtë të flas sepse këto nuk janë të përcaktuara në ligj. Në diskutimin e rregullores u bë një trajtim më i gjërë i çështjes, të cilin për hir të së vërtetës e përgëzoj, por pjesëmarrja apo ekzistenca e dhomave të këshillimit, dhomave të mbyllura ku as në ligj nuk parashikohet dhe as në ligjin "Për organet kolegjiale" nuk parashikohet, kjo shkon tërësisht tej asaj që ligji përcakton. Sepse është është e qartë këtu sipas pikës 40 që do të ketë një dhomë këshillimi e cila nuk parashikohet përveçse në procedurat gjyqësore dhe nëse ky organ funksion si organ gjyqësor është diskutim tjetër por gjithsesi duhet të jetë në përputhje me ligjin. Vendimmarrja është e juaja dhe më shumë se për çdo gjë duhet të kujdesemi jo për vendimmarrjen konkrete por për të larguar perceptimin se ne i marrim vendimet midis nesh, nuk kemi transparencë dhe çdo gjë bëhet me dyer të mbyllura. Pra të paktën ato garanci që janë përcaktuar transparenca, llogaridhënia, marrja pjesë në çdo mbledhje

e gjithë individëve është e garantuar, edhe marrja e çdo lloj informacioni. E drejta e informimit këtu për shkak se ligji e përcakton mbledhjen të mbyllur ka lënë një lloj garancie e cila është garanci më shumë për Këshillin që vendimmarrjet e tija të mos jenë vendimmarrje që të paragjykoen qartësisht si vendimmarrje të mbyllura dhe jo transparente. Për mua personalisht ky është një mandat i shtuar, pa asnjë kapacitet më tepër, pa asnjë buxhet më tepër, është një punë tjetër që unë duhet ta bëj përveç punëve që kam si detyrë funksionale për ta bërë. Por përgjegjësinë e mbaj sepse reforma në drejtësi është reforma më e rëndësishme për të mirën e popullit shqiptar dhe garantimi i zbatimit të saj me seriozitet dhe në përputhje me qëllimin për të cilin u bë është detyrë thelbësore e çdo individ, për më tepër e këtij Këshilli që ka individ kaq kualitativ dhe të zotët për të marrë vendimmarrje përtej diskutimit nëse do të jetë apo s’do të jetë Avokati i Popullit prezent në mbledhje. Prezenca e institucionit të Avokatit të Popullit do të jetë një vlerë e shtuar për këtë KED dhe për gjithë KED-të e tjera dhe këtë e besoj fort dhe për këtë arsye gjykoj që vendimmarrja e Këshillit në lidhje me këtë çështje duhet të jetë në linjë me ligjin dhe me parashikimet e rregullores për sa i përket marrjes së informacionit, të dokumentave dhe pjesëmarrjes në mbledhje

Anëtarët e Këshillit, vijonë diskutimet e tyre në lidhje me procedurat e njoftimit, të njohjes me relacionin, materialet dhe mënyrën e vendimmarrjes në procedurat e verifikimit të kandidatëve.

Genci Gjonçaj kërkon fjalën dhe parashtron se nuk ka ndonjë kundërshtim ndërmjet rregullores së brendshme dhe dispozitës të propozuar. Parashikimet duhen parë në tërësi, nuk mund ti referohemi vetëm pikës 34, pa lexuar dhe çfarë vjen më poshtë, pikat 35, 36, 37, 38 të cilat janë veprime procedurale për të cilat Avokati i Popullit njihet. Në të gjitha këto pika, e drejta për të marrë informacion e Avokatit të Popullit është e garantuar nga mbledhja dhe nga kjo dispozitë. Këtu jemi përpara një akti i cili normon një procedurë dhe logjikisht tek këto nenet përcaktohen një pjesë e procedurës që do të ndjekë KED dhe fillon me përgatitjen e materialit nga relatori, njoftimin që i bëhet avokatit të popullit, njoftimin që i bëhet të interesuarit dhe këto janë elementet që i interesojnë dhe duhet ti interesojnë në pozicionin e vëzhgusit Avokatit të Popullit. Përmbajtja dhe biseda se si gjykohet, si arsyetohet nga relatori, është çështje e relatorit dhe vendimmarrja është një çështje e Këshillit dhe nuk besojmë që, në këtë pikë mund të ketë një ndikim Avokati i Popullit. Të gjitha janë të parashikuara, në pikën 36 në dispozicion të avokatit të popullit vihet relacioni. Në pikën më poshtë, me prezencën e tij avokati i popullit siguron informacionin për të gjitha procedurat dhe faktet që kanë rezultuar gjatë verifikimit të përmbushjeve të kushteve dhe të kriterëve të tjera ligjore për kandidatët. Informacion më tej i jepet në pikën 39 që “*pas anëtarve të Këshillit nëse e vlerësojnë, avokati i*

popullit mund të parashtrorë mendime dhe vlerësime në lidhje me aspektet procedurale të procedurës së ndjekur për verifikimin e kandidatëve”. Është një çështje që zhvillohet ndërmjet kandidatit dhe Këshillit. Edhe nëse një kandidat është i pakënaqur me një mendim të relatorit e për rrjedhojë edhe të Këshillit, ka një dispozitë më poshtë, të drejtën për të shkuar në gjykatë. Këto janë elementët proceduralë për të cilat duhet të kujdeset avokati i popullit për të qenë pjesë e këtij akti. Pjesa tjetër, është pjesë e gjykimit të relatorit dhe Këshillit. Avokati nuk mund të jetë dot as relator dhe as anëtar i Këshillit. Është vëzhgues, në një pozitë të veçantë ndryshe nga përfaqësuesi i Presidentit, ndryshe nga përfaqësuesi i Kryetarit të Kuvendit dhe ndryshe nga procedura e dy anëtarëve të Komisionit të Ligjeve. Ne kemi bërë një proces paralel për zgjedhjen e anëtarëve të KLP dhe të KLGJ. Kam qënë në pozitën e relatorit dhe kam prodhuar një relacion. Këtë relacion e kam bërë publik dhe ja kam dërguar avokatit të popullit. Por e gjithë veprimtaria e ndjekur në këtë rast, është menaxhuar nga sekretari i përgjithshëm, përfshirë të gjitha dokumentat e mbledhura nga ILDKPKI, AIDSSH por edhe nga shërbimet sekrete. Por është një informacion i cili ka rezultuar i përfunduar, i bërë publik dhe i njohur për të gjithë nëpërmjet një relacioni dhe unë mendoj se ky relacion është i mjaftueshem për të treguar bindjen nesë procesi ka ecur proceduralisht sipas përcaktimeve të Kushtetutës, ligjit, Rregullores së Kuvendit.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe parashtron se këtu u bë një diskutim i gjatë dhe fjala është pikërisht për pozitën e Avokatit të Popullit dhe nuk folëm për pozitën e institucioneve tona. Ne atë pozitë e kemi pranuar në rregulloren e parë dhe në rregulloren e dytë nuk besoj se ka ndryshim, të paktën nga këto nenet 35 tek neni 41. Por, pozita e Avokatit të Popullit si institucion kushtues ka dy anë në këtë proces. Ai është Avokati i Popullit. Popull është si kandidati që merr pjesë por edhe njerëzit që presin emërimin dhe plotësimin e Gjykatës Kushtetuese, se si po zgjidhen ose po renditen kandidatët në Gjykatën Kushtetuese, ku i gjithë populli do i drejtohet në rast se do të shkelet një e drejtë apo do të ankohen tek ILD për të gjitha ankesat ndaj gjyqësorit apo prokurorisë. Prandaj, kushtetutbërësi, ligjvënësi, edhe me ekspertizën ndërkombëtare, ka parashikuar që të jetë që në fillim Avokati i Popullit, që kur hidhet shorti për tu zgjedhur në KED dhe të bëjë dhe një raport, ku ti rekomandoj Kuvendit përmirësimet e procedurës për vitin që vjen apo Presidentit. Avokati i Popullit zgjidhet politikisht nga Kuvendi, aty ngrenë dorën aktorët politikë por nuk është politik. Është i pavarur, kushtetues dhe super garantues në intesin e publikut. Rregullat që janë miratuar nga ky këshill mund të ndryshohen, patjetër që mund të ndryshohen. Por në drejtim të përmirësimit të pozitës të subjekteve. Subjekti i cili është dhe Avokati i Popullit. Mosdhënia e akteve Avokatit të Popullit apo kufizimi i pjesëmarrjes së tij në disa momente të vendimmarrjes, nuk u

argumentuan bindshëm deri më tani. Edhe nga EURALIUS nuk pashë ndonjë argument të bindshëm se pse rregullat që janë miratuar duhet të ndryshohen. Në këto kushte, mendimi jonë për pozitën e Avokatit të Popullit është që aktet ti vihen në dispozicion dhe të jetë pjesëmarrës në mbledhje siç e parashikon ligji.

Anëtarët e Këshillit, vijonë diskutimet mes dhe në përfundim të tyre diskutimeve, kaluan në procesin e votimit të zgjidhjeve që duhet të reflektohen në formulimin e dispozitave të projektaktit.

Në lidhje me dërgimin Avokatit të Popullit, krahas relacionit të detajuar, edhe të materialeve të përgatitura nga relatori, rezultati i votimit është **4 me 2. Votuan pro anëtarët Arta Marku, Fatri Islamaj, Margarita Buhali dhe Eriol Roshi. Votuan kundër anëtarët Ardian Dvorani dhe Vitore Tusha.**

Rezultati i votimit është **4 me 2** që ti jepet fjala Avokatit të Popullit ku mund të parashtrijë mendime dhe vlerësime vetëm në aspektin e procedurës tek pjesa e procedurës. **Votuan pro anëtarët Vitore Tusha, Margarita Buhali, Arta Marku dhe Fatri Islamaj. Votuan kundër anëtarët Ardian Dvorani dhe Eriol Roshi.**

Lidhur me pikën 40 dhe 41, rezultati i votimit është **3 – 3. Anëtarët Arta Marku, Fatri Islamaj dhe Margarita Buhali** votuan që, që pas relatimit dhe pyetjeve sqaruese, në bisedimin dhe votimin për dhënien e vendimit të mos jenë vetëm anëtarët e Këshillit. **Anëtarët Ardian Dvorani, Vitore Tusha dhe Eriol Roshi** votuan që në bisedimin dhe votimin për dhënien e vendimit të jenë vetëm anëtarët e Këshillit. Në kushtet e rezultatit të votimit **3 me 3**, sipas rregullave të KED prevalon vota e kryetarit të tij, pra në bisedimin dhe votimin e vendimit të jenë vetëm anëtarët e Këshillit.

Anëtarët e Këshillit, vijonë diskutimet dhe në përfundim të tyre miratojnë me riformulime pikat 42 deri 47 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit, vijonë diskutimet lidhur me pikën 48 të projektaktit, mbi rastet kur pas shqyrtimit të relacionit rezultojnë të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit por që kandidati nuk ka dhënë shpjegime.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtron se në këtë dispozitë keni parashikuar që materialin do tia dërgoni kandidatit, por ne a do të na i dërgoni apo keni logjikuar që ne nuk marrim më pjesë sepse jeni akoma dhomë këshillimi. Nëse do ti çohet kandidatit, ka një qëndrim dhe ka një ndryshim procedure, pra do ndryshojë relacioni. Atëherë unë propozoj dhe gjykoj që në këtë pikë duhet të përfshihet fakti i njoftimit që ju keni vendosur diçka ndryshe nga relacioni e për sa kohë që është çështje procedure do të duhet ti njoftohet dhe Avokati i Popullit. Ngelet çështje procedurale njësoj siç i njoftohen kandidatët. Është pjesë e veprimtarisë suaj nuk

është pjesë e vendimmarrjes ose të themi pjesë e vendimmarrjes së panënshtuar transparencës apo ku di unë të themi “transparencës” ne thonjëza. Nuk dua të dal në kuptim negativ por vazhdon të jetë pjesë e qëndrimeve të Këshillit për kundërshtimin e relacionit. Pra praktikisht ne e kishim një relacion, tani ka ardhur një informacion tjetër dhe është çështje procedure. Duket që këshilli nuk ka të njëjtin qëndrim parimisht si për relacionin. Unë mendoj që i njëjti njoftim, së bashku me kandidatin mund ti dërgohet edhe subjekteve të tjerë për ti thënë që për këtë arsye e rast në relacion nuk rezulton të jetë përfshirja ose përmbledhja e të gjitha ... Ne duhet të kemi të paktën informacionin që del publikisht në komunikatë. U konsiderua që ka një dhomë e këshillimi e cila është ndryshe nga veprimtaria e Këshilli. Ky është vendimi juaj. Por në çastin që ju dilni nga dhoma e këshillimit me këtë njoftim që do dalë nga dhoma e këshillimit unë besoj që duhet ta bëni dhe duhet tja bëni dhe subjekteve të cilat janë të ftuar. Pra nëse dilni nga dhoma e këshillimit dhe kthehemi në procedurë normale, jeni duke e njoftuar edhe kandidatin për 1-2 gjetje, nuk rëndësi si e keni bërë vendimmarrjen tuaj, duhet të na njoftoni edhe neve që keni dalë nga dhoma e këshillimit .

Gjatë kohës që bën relatori procedurën unë vëzhgoj veprimtarinë, marr informacion në çdo kohë , kështu është e përcaktuar. Tani u përcaktua nga kjo mbledhje që në momentin në të cilin do të jeni në vendimmarrje nuk ka vëzhgues, por kur dilni nga vendimmarrja sepse po kërkon të bëni hetim tjetër, të dilni prapë në seancë që do të vazhdoni hetimin gjyqësor unë nuk mund të rri tërë kohën në faqe interneti. Prandaj siç na komunikoni në mbledhje që tani po futemi në dhomë e këshillimit, duhet të na komunikoni që po dilni nga dhoma e këshillimit për X, Y apo Z çështje.

Anëtarët e Këshillit, miratojnë me riformulime pikën 48 të projektaktit dhe vijojnë diskutimet mes tyre lidhur me pikën 49 të tij.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtron se fakti që ne lejuam shpalljen për efekt të ILD kjo ishte për shkak se kishte një paqartësi kushtetuese në lidhje me faktin nëse është shpallur ndonjëherë apo kur fillonin afatet. Dhe me atë rast, ky Këshill mori një vendim specifik, për një çështje specifike dhe për kushtet në të cilat ndodhej të themi vëndi. Në rastin konkret mendoj se do të ishte më mirë që ky Këshill t’ia dërgonte Kuvendit apo Presidentit që janë organe përkatëse të nominimit, listën siç ju rezulton dhe nëse ata thonë nuk ka aq kandidatë sa duhet, ta kthejnë mbrapsht. Pra, nuk është përgjegjësi e jona, por është përgjegjësia e atyre organeve që nesë nuk gjejnë ato kandidatura të vlefshme ta kthejnë. Në rastin konkret, nuk do të isha gati që këtë gjë tja linim si kompetencë këtij Këshilli. Aq më tepër në këtë kohë, në të cilën vendi duhet të ketë Gjykatën Kushtetuese. Le të jenë organet përkatëse që të thonë nuk keni kandidaturat e duhura, kjo është përgjigjësi shumë e madhe.

Agnes Bernhard (*përkthen përkthyesja*) kërkon fjalën dhe parashtron se nuk është se ju keni ndonjë dispozitë shumë të qartë e specifike në ligj e cila ju kërkon juve ose rihapjen e rastit për tu paraqitur kandidatura të tjera ose për të vijuar më tej me procesin. Kështu që sipas mendimit tim është çështje interpretimi. Në këtë kuadër mendoj që ne duhet të eksplorojmë frymën që vjen nga i gjithë procesi. Dhe sigurisht që procedura në vetvete duhet të mbështetet tek meritat ose duhet të kemi thirrje të hapur në mënyrë që mund të sigurojmë një qëndrueshmëri sa më të madhe të jetë e mundur të kandidatëve. Është e rëndësishme që të ketë variacion pra të ketë larmi të kandidatëve, konkurrencë ndërmjet tyre që pastaj përzgjedhja të bëhet duke respektuar parimet e përmendura më sipër, dmth përzgjedhje mbi bazën e meritës dhe miratimin e kandidaturave që i kanë cilësitë e nevojshme. Për mua ky do të ishte arsyetimi për të marrë vendimin për rihapjen e thirrjes së kandidaturave të reja. Besoj që kemi edhe elementin tjetër, pra kemi dispozitën kushtetuese dhe ligjore që kërkohen numra të përcaktuar të kandidatëve për të marrë pjesë, në varësi të institucionit për të cilin bëhet fjalë, për shembull për Gjykatën Kushtetuese kërkohen 3 kandidatura, për Inspektoriatin kërkohen të paktën 5. Kështu që sërish edhe analizimi ose kërkesat duhet të bëhen në vazhden e të njëjtës llogjikë që unë thashë më përpara, në mënyrë të tillë që Parlamentit ose Presidentit ose Gjykatës së Lartë të mund të marrin vendimin dhe ku mund të sigurohet i njëjti cilësi kandidaturash. Pra organet emëruese, e kam fjalën për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, por edhe Parlamenti, Presidenti e Gjykata e Lartë, në mënyrë që të kenë mundësi që të përmbushin ato kushte dhe të gjitha parashikimet që i jepen në ligj, do duhet që të përmbushin këtë elementin e përzgjedhjes. Pra duhet të kenë kandidatë të mjaftueshëm në mënyrë që të mund të përzgjedhin kandidatët për organet përkatëse. Edhe ky do të ishte një argument në favor të rihapjes së thirrjes për kandidatura të reja. Megjithatë, një ndër kërkesat e Kushtetutës dhe të ligjit është ai i përmbushjes së detyrimeve në afatet kohore të cilat siç e dini dhe ju janë afate strikte. Për këto arsye dhe ato që juve i përmëndët, është e rëndësishme që të vijohet me procesin, të mos bllokohet procesi sepse nuk mund të kërkosh një njeri që s'ka më interes për të kandiduar që të kandidojë me zor. Por, nga ana tjetër duhet që të çbllokohet procesi që të vijohet më tej me respektimin e afateve kohore. Dhe opsionet janë ato opsione që juve i parashtruat pak më përpara. ***Së pari*** dmth një opsion është që, mbase të kërkohet një herë rihapje me argumentet e respektimit të konkurrencës ose të ofrimit të kandidatëve nga të cilët mund të përzgjedhin këto organet e emërimit. Në qoftë se bëhet rihapje shumë herë atëherë nuk përmbushen parashikimet dhe kërkesat e ligjit, për aq kohë sa nuk sigurohet funksionimi dhe operimi normal i organeve kushtetuese dhe i organeve të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligj. Kështu që, në përmbyllje, më lejoni të them që sipas mendimit dhe interpretimit tim mund të ketë hapësirë ose mund të

jetë e përshtatshme që të kërkohet njëherë rihapja ose rithirrja për kandidatë të tjerë, por kjo gjë nuk duhet të bëhet pafundësisht sepse në këtë mënyrë nuk do të sigurohet pluraliteti dhe nuk do të sigurohet të themi opsioni i përzgjedhjes nga organet emëruese dhe nuk do të lejohet që organet kushtetuese të fillojnë të funksionojnë.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtrohet se një çështje tjetër që ka lindur edhe nga praktika ndoshta mund të jetë fakti se cili është momenti kur ky Këshill vihet në dijeni të rënies së numrit nën 3 për kandidimet. Edhe kjo mundet të tregojë, në një mënyrë ose në një tjetër, mirëbesimin e Këshillit në lidhje me pluralitetin apo edhe në lidhje me faktin për ta vënë në kohë e në mënyrën e duhur në dijeni organin e emërtesës. Problemi që kam unë është tani për të treguar mirëbesim se s'kemi edhe kohë, jemi në një situatë të tillë. Ju keni dhënë dorëheqjen, nuk ja keni dhënë relatorëve, ja keni dhënë gjithë Këshillit. Ajo emërtesë ka rënë nën numër. A duhet ne të presim sa të mbarojnë të gjithë këto që ta thotë këtë gjë relatori? Nuk mund ta lëmë vendin pa Inspektor apo nuk mund ta lëmë vendin pa Gjykatë Kushtetuese. Nëse Këshilli kupton që pa mbaruar kjo procedurë që është bërë deri më tani nuk e ka numrin për shkaqe nga më të ndryshmet, largqoftë vdes njëri nga kandidatët, po përmendin rastin konkret bie numri nën minimum a do të presim relatorin? Publiku mund të na thotë që pse ju nuk vepruat në mënyrë të shpejtë e të menjëhershme siç vepruat për Inspektorin edhe për rastet e tjera?

Anëtarët e Këshillit, pas diskutimit të mëtejshëm e kalojnë me riformulime pikën 49 të projektaktit

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi merr mendimin e anëtarëve për ndërprerjen e diskutimeve dhe vijimin e tyre në mbledhjen e ardhshme, përcakton zhvillimin e saj në datën 11 Mars, në orën 15.00, me të njëjtin rend dite: *Diskutimi dhe miratimi i projektvendimit për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin i Lartë të Drejtësisë*, deklaroi mbylljen e mbledhjes.

MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 14.20

Sekretare

Kryetari

Dorina Dulaj

Ardian Dvorani

Ermelinda Kadiu

Redjona Myrtja

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga personel i vetë institucioneve të ftuar.